

Pikëvështime të Lef Nosit për gjuhën shqipe përmes shënimeve të tij dhe letërkëmbimit me personalitete të kulturës dhe shkencës

Ka personalitete që për arsye të motit a klimës politike erdhën deri në ditët tona me profile të mjegulluara a jo shumë të qarta të personalitetit të tyre shkencor dhe të kontributit të tyre në dobi të kombit e çështjes kombëtare. Pavarësisht entuziazmit dhe kërshtërisë së publikut, ata mbetën në largësi si objekte me një lartësi përgjithësisht të papërcaktuar. Por kur moti fillon të qartësohet dhe mundohesh të vështrosh më nga afër vlerën e tyre, ato sërish të befasojnë me përmasat që paraqesin, të cilave sa më pranë t'u qasesh, aq më shumë shfaqen të larmishme në madhësi, në forma dhe profile. Kjo larmi të nxit edhe më shumë për ta njohur këtë shfaqje poliedrike të personalitetit përkatës; kjo larmi e bën edhe më joshëse natyrën e shqyrtimit, sepse profilet shfaqen tërheqëse jo vetëm në dukje, por sidomos edhe në thellësi, në fusha e lëminj studimi po ashtu tejet të ndryshëm. I tillë na shfaqet personaliteti i Lef Nosit i lidhur jo vetëm me interesimet e studimet e tij për historinë e kulturën shqiptare, por edhe në lidhje me gjuhën shqipe, historinë dhe aktualitetin e saj. Ruhet edhe në këtë sferë të kontributeve dhe interesimeve të tij po i njëjti pasion, po e njëjta thellësi, si edhe në fusha të tjera ku ndoshta ai është më shumë i identifikuar si kontribues.

Sigurisht, shqyrtimi i këtij profili të personalitetit të L. Nosit nuk kërkon të shtojë ngjyrimet e paqena në këtë figurë; Lef Nosi, sigurisht nuk ka qenë gjuhëtar në kuptimin që termi merr në kohën tonë në lidhje me studiuesin që synon të studiojë nga afër, me objektivitet dhe falë një metodologjie të përcaktuar qartë, objektin gjuhë/ligjërim; por interesimet e tij për gjuhën shqipe, historinë e saj, natyrën dhe prejardhjen e saj, interesimet dhe konsultimet e gjera të literaturës që lidhet me gjuhën shqipe dhe për gjuhën shqipe të albanologëve e dijetarëve më në zë pararendës e bashkëkohës të L. Nosit, e sidomos kontakti dhe pjesëmarrja aktive e tij në grupimin e njerëzve e personaliteteve diturore e intelektuale të kohës që ndikonin drejtpërdrejt në hartimin e politikave gjuhësore të zhvillimit të shqipes në kohën kur ai jetoi, na bëjnë të shohim me entuziazëm edhe këtë profil interesant në personalitetin poliedrik e enciklopedist të L. Nosit; dhe të vlerësojmë pa rezerva kompetencën e plotë filologjike të tij, njohuritë e thelluara të tij për historinë dhe origjinën e gjuhës shqipe dhe angazhimin e tij pa ngurrim në shërbim dhe dobi të zhvillimit të saj. E kemi shqyrtuar këtë profil përmes letërkëmbimit me disa nga personalitetet më në zë të

fushës së gjuhësisë dhe përmes disa shënimeve të tij për gjuhën shqipe, si një hap të parë për të krijuar një platformë më të gjerë kërkimi në këtë fushë, pas konsultimit më të plotë të fondit të L. Nosit jo vetëm pranë AQSH në Tiranë, por edhe fondit të tij në Dubrovnik.¹

Duke u njohur më nga afër me interesimet e tij në fushë të gjuhës, vëren natyrën enciklopediste të trajtimeve të tij dhe nuk mënon ta rendisë atë krahas personaliteteve të tjera që shërbejnë si modele në këtë hapësirë, si P. Bogdani, F. Bardhi, S. Frashëri, K. Kristoforidhi, F. Konica, F. Noli etj., ndaj të cilëve metodologjia në shqyrtim duhet të jetë e përshtatur mirë me strukturën e kontributeve dhe interesimeve të tyre. Është një model i ngjashëm me to, sepse interesimet e tij për gjuhën shqipe shfaqen qoftë në formën e gjurmimit, ruajtjes a nxjerrjes në dritë të monumenteve shkrimore, siç është rasti i ruajtjes së dorëshkrimeve të Kristoforidhit dhe Dh. Todrit, i dorëshkrimit të Papa Totasit për origjinat e shqipes së shkruar, ose edhe më gjerë, grumbullimi i dokumenteve historike të gjykatës turke, i arkivit të sheriatit të Elbasanit, qysh nga viti 1560, i regjistrave të vjetër të esnafëve myslimanë e të krishterë, e deri te mbledhja e visarit folklorik “Këngë legjendare” dhe “Cikli i kreshnikëve”; qoftë në formën e studimit të drejtpërdrejtë të historisë së gjuhës dhe popullit shqiptar, në formën e shënimeve të imtësuar me referenca të drejtpërdrejta të autorëve më madhorë dhe veprave më përfaqësuese në fushën e albanologjisë deri në atë kohë, me shqyrtime dhe interpretime me kompetencë të dukurive gjuhësore dhe qëndrime të motivuara për çështje madhore si ajo e alfabetit të shqipes dhe zgjidhjes së problematikës së tij në Kongresin e Manastirit, e deri në interpretimin e vlerave të shqipes dhe klasifikimin e saj në trungun e gjuhëve indoeuropiane si *lingua satem* a *centum* - ose në përkushtimin e tij për studimin e formave dialektore, madje deri te të folmet e arbëreshëve; qoftë edhe në krijimin e modeleve gjuhësore që priren drejt një gjuhe më të përbashkët e më funksionale në ato etapa të ndërlikuara të zhvillimit të shqipes, ku koleksionet e “Kopshtit Letrar”, të drejtuara prej tij a të gazetës “Tomorri”, kërkoheshin të ishin pronë e bibliotekave albanologjike dhe shembuj ilustrues gjuhësorë në mësimdhënien e gjuhës shqipe. “Kemi kohë, - i shkruan K. Cipoja nga Liceu i Korçës L. Nosit,- që po përkëdhelim një mendim të bukur! Krijimin e një biblioteke albanologjie në Lyce... Me këtë rasë dëshirojmë të kemi nga ju një ose dy koleksione të rivistës “Kopshti Letrar” dhe disa numra të “Tomorrit” [F.32.D.55.1 fl 63 j.p.g.]; ose në një letër tjetër dërguar nga Shkodra ai i shkruan: “Un po të lutem të më

1 Në këtë rast falenderojmë edhe punonjësit e AQSH në Tiranë, zonjat Suela Çuçi e Suela Voro për ndihmën që na kanë dhënë, duke na vënë në dispozicion materialet nga ky arkiv, dhe në mënyrë të veçantë, zotin Armando Boçe, i cili u tregua i gatshëm të na vërë në dispozicion materiale të skeduar prej tij në lidhje me letërkëmbimin e L. Nosit për problematikën për të cilën ne interesoheshim.

dërgosh edhe një koleksion të “Kopshtit Letrar”, pse më duhet me zgjedhë, t’a marrish vesht, ca copa të mira të shkrueme në dhialektin t’on, për me u a dhanë nxanësve si këndim, mbasi simjet, në gjimnast nuk dua t’a përdor fare dhialektin e Shkodrës. Po pate ndonji sent tjetër të Kristoforidhit m’a ço pa vonesë.” [F.32. D.55.1 fl 61 j.p.g.]

Në rrugëtimin për të njohur përmasat e kontributit të personaliteteve të tilla edhe letërkëmbimi, edhe shënimet e lëna të pabotuara janë ndër shtigjet që mundësojnë njohje. Letërkëmbimi është hapësirë ku përcaktohet në mënyrë të qartë statusi i përçuesit të mesazheve në raport me këmbyesin e këtyre mesazheve; është mundësi për të përftuar një rezultante të fazave të ndryshme të evoluimit të koncepteve dhe shqetësimeve intelektuale; është hapësirë afektive ku shfaqen drejtpërdrejt parapëlqimet dhe mospëlqimet në raport me dukuritë që pasqyrohen; është tregues i statusit real të përvijuar nga personaliteti në raport me mjedisin, kontekstin e shqyrtimeve dhe dijen e kohës; ndërsa ‘shënimet e lëna të pabotuara’ janë mundësi për të njohur hapësirat e shtrirjes së interesimeve shkencore e diturore të personaliteteve të tilla që karakterizohen në masë të konsiderueshme nga veprimi praktik në dobi të një kauze të madhe e kombëtare, duke i dhënë këtij veprimi përparësinë në raport me veprën e shkruar, e cila në këto kontekste shtyhet për botim e përpunim në një kohë të dytë, të tretë..., sepse ato kontekste kërkojnë, më së pari, *veprimin* dhe pastaj *dëshminë* e *interpretimin*. Është tepër domethënëse një letër që Lef Nosi i dërgon nga Elbasani Luigi Gurakuqit në Vlorë më 9/1913 për masat që duhen marrë sa më shpejt për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Vërehet qartë në tekst shpirti i veprimit dhe përgjegjësia ndaj mbarëvajtjes së shtetit të sapokrijuar. Me mirëbesimin e mikut të tij bashkëluftëtar, por edhe përgjegjësinë e intelektualit e shtetarit ai shkruan: “Si e dini propaganda greke po bâhet gatië për me hapë shkollat e saja gjithkund. Priti të shohë kundërshtimet q’ish matur shumë t’i bâhen nga an’e qeverriës edhe passi nuk pa gjâ mori guximin. Sikurse propaganda qi përmenda ashtû edhe ajo e Rumunvet e të tjerat kanë me bâmë. Në qoftë se besojmë qi propagandat² do t’a kenë sot Europën për methe për me na shtrëngue ne atherë do t’a kena ca mâ tepër në qoftë se i lâmë një herë të punojnë edhe pastaj i pengojmë. Asht detyra e jonë sot qi të mos i trashëgojmë qeverrivet të pastajme një zgjedhë të pathyeshme. Këtu n’Elbasan si në një vend ku trullin nuk e kanë aqi të shëndoshë propagandat e huja gatitjet e hapjes së shkollavet po mënojnë. Kjo na ep arsye për me kundërpunue e me i hapë shkollat e tyre sa mâ parë shqipe e n’emën të qeverrisë shqiptare qi kështû t’a pështojmë vendin nga kjo e ligë. E ke detyrë pra qi t’udhëheqësh me vrap drejtorin e Arsimit për me marrë masat e nevojshme e me i hapë të Hanën qi vjen shkollat n’emën të qeverrisë. Protestime do të punoj un qi të mos bâhen aspak nga populli.

2 Vendet që zhvillonin propagandë kundër shqiptarëve

Në bâftë dhespoti po qeverria do t'a ketë shkresën e popullit në dorë e s'e njof. Lef Nosi" [A. Q. Sh. i R. Sh. F. 34, D. 36, fl. 34].

Për figura të tilla si ajo e L. Nosit, për të cilin veprimi i përditshëm, në vijimësi, në shërbim të politikës, dijes a kulturës mbushte një jetë jo të zakonit, letërkëmbimi është shteg që të mundëson të shohësh konkretisht interesimet, kontributet dhe vlerat e asaj përditësie dhe 'shënimit', të kuptosh statusin e kontributit të personalitetit në veprimin praktik, status i lartë, sepse përvijohet nga kontekstet e dijes, kulturës dhe shkencës. Letërkëmbimi është mundësi për njohjen më të thellë të jetës së personalitetit, e cila në vetvete mund të përbëjë në tërësi një vepër madhore të pabotuar, por në një kuptim të caktuar edhe të pabotueshme, sepse ajo është e përbërë dhe shpërndarë në grimca dhe pjesë në përditshmërinë praktike të njeriut, në shërbim të një kauze të madhe; studimet, shënimet dhe interpretimet e natyrës shkencore e diturore që mbeten pa e parë dritën e botimit, janë po ashtu tregues i përballjes së personalitetit në fushën e mendimit shkencor, në të cilin kërkon të jetë "i mirarmatosur" për të qenë fitimtar, ndaj nuk shfaqet në fushëbeteje pa u përgatitur sa duhet për një fitore të sigurtë. Ndaj L.Nosi priste e mëtonte për përsosje dhe thellim të mëtejshëm. Në një letër të dërguar nga Shën Mitër Korone më 30.1.1909, mes të tjerave A. Xhuvani i shkruante këto fjalë L. Nosit: " [...] punët e tua qi ke gati... un themi qe t'i botosh ke "Albania" ne menyre monografie, si po botoj un pjësen etymologikë te Shkronjetorës, pastaj i qet ne drite édhë si liber. Mos i ngroh pra ma po nzirri », [F. 32, D.55 fl. 58-59]. Mëse një herë në historinë e dijes ka ndodhur që shënime e shqyrtime të tilla të shohin dritën e botimit dhe komunikimin me lexuesin *post-mortem*. Por në rastin e L. Nosit, bashkë me autorin, edhe vepra e tij që mund të botohej *post-mortem*, u dënua po ashtu me vdekje.

Letërkëmbimi është një nga mënyrat më të frytshme për të përcaktuar statusin shoqëror, dituror e shkencor të personalitetit në raport me kohën dhe bashkëkohësit, sepse, në një farë mënyre, letërkëmbimi është edhe një lloj piedestali ku letërdërguesi të vendos përmes mesazheve të tij në raport me të tjerët. Përtej klisheve të mirësjelljes në adresim, brendia e mesazheve, qofshin ato edhe të natyrës intime, familjare a miqësore bart spontanisht dhe natyrshëm gjurmët e një lartësie të caktuar sociale e kulturore që letërdërguesi ka arritur, dhe nga ana tjetër, në letrat dërguar atij, në këtë brendi vërehet lartësia në të cilën të tjerët shohin ku ai është vendosur. Për L. Nosit qartësimi i këtij statusi është i rëndësishëm, pas denigrimit dhjetërvjeçar në opinion që politika e pasluftës i bëri atij.

Nuk është thjesht mirësjellja në adresim që F. Konica i shkruan L. Nosit: " I shtrenjti mik"; me të njëjtën ndjenjë respekti dhe vlerësimi ai vazhdon: "Ne nje lëtre qe me dergoj ca dite me pare, X. Al. Zuvani me thote qe po te mérrëmi vésh mé te dy (ju dhe une), "çeshtja é alfabetit do te xgjidhét mé nje hére". Une nuk bésoj te kémi ate fuqie q'i pelqén mikut t'one te na

Si do qe ne qofte, sa per t'u mare vësh, kujtoj q'u-muarne aqe sa me mire nuk behët... .. Une, im mik, bësoj qe nuk do t'a pakesoni émrin tuaj duke u-perxjére mé keta njéres." [F. 32, D. 55 fl 58-59] ; Sotir Peci nga Bostoni i shkruan mes të tjerash : "Mik i dashur, Pushimi t'uaj kace kohe na vuri ne hupé te madhé, U lutémi shume te na shkruani per sa shpéjte ce te cétesohémi... .. per gne konferénze t'Shciptarevét ... që do te mbahét ne Elvéti me te tsilen pervéch cheshtjevé se tjéra do te xghidhet dhe é abés." [F. 32, D. 55/2 fl 92] ; Jani Minga i shkruan : "Atdhetar i flakt, Për fat të keq ball-faqe nuk njihemi me zotrin t'uaj po ndienjat të larta atdhetare t'uajat më jan kaq të ditura sa kuxoj t'ju shkroj drejt për drejt pa dorë të druajtur." [F. 32, D. 55/1, fl. 21]. Ja çfarë shkruan Stefan N. Kondilari nga Korça : "Kam kenë shumë i lumtun kur kam dëgjuar për ju, se ini përpjekun edhe nuk lodhi kurrë për dëshirat e Atdheut tonë dashun. » [F.32, D.55/2 fl.116-117]; Ndërsa Kristo Dako thekson : « Miku im i dashurë Lefi, ... Unë punën t'uaj që kini bërë me "Tomorë" dhe me shumë të tjera gjera atdhetarije i di dhe i kupëtonj si janë dhe gjithë një kam simpathisue dhe simpathis me yve; e di se gjithë një kini punuarë për të mirën e të tjerëve dhe jo për të holla. Pa dyshim shpejt do të vinjë koha kur shërbimet t'ueja do të çmohen nga të gjithë." [F. 32, D. 55/1 fl. 72-73], ndërsa Papas Gaetano Petrota thekson në një prej letrave të tij: "I nderuari Z. Lef Nosi, Unë s'di në Z. juej mbani në ment se pata të iu shkruaja në kohë të botimit të s'bukurës gazette Tomorri që më duket ngjër më sot një prej më të mirat gazette të botuara në Shqypëri..... Unë kam bër fjalë te libri jem për lëvizjen kombëtare e kam kujtuar të parët hape të organizimit të Shtetit Shqiptar, tuke përmendunr edhe se Z juej klë një nga më të nzehtit patriotë në kohrat që mënt t'thoni eroike në Stori të Kombit..... Z. juej njeh mire veprat t'ona në lame të shtypshkrimeve shqype e në lame të kombëtarizmit: Lëvizja jonë s'kâ patur tjetër frymësi veç se dashurîn e atdheut të stërgjyshave t'anë..... Z. juej kini në duar shumë dokumenta e kini në zëmërë shumë kujtime, ndai jini zot të shkruani një histori të plotë të lëvizjes kulturele – kombëtare të Shqypëris në kohra të fundit.... Ju lutem, zotni të më shkruani në kini gjetur gabime a se mungesa te libri jim e jú lutem edhe të më thoni në kini botime që interesojn të jën përmendurë te vepra jime. » [F. 32, D. 55, fl. 213-214].

Për më tepër, në këtë status, përmes letërkëmbimit mund të shihen edhe vlerat njerëzore të personalitetit. Studiuesi mund të nisë të shkelë me droje në ato shtigje që të çon ky letërkëmbim, sepse ndodh hera-herës që të mos përputhen përmasat e personalitetit në veprim në shërbim të kauzës dhe dijes a shkencës, që vijnë prej talentit, dhuntive, me ato të njeriut jashtë veprës, jashtë politikës, jashtë dijes. Por në rastin e L. Nosit, edhe pse shqyrtuam vetëm një pjesë të korrespondencës dhe shënimeve të tij për gjuhën shqipe dhe shqiptarët (kryesisht në dhjetëvjeçarin e parë te shekullit XX), çdo dokument i gjetur, veçse na e shtonte entuziazmin dhe bindjen që

kemi të bëjmë me një personalitet të përvijuar qartazi në fushën e dijes për të cilën u interesuam, në lëmin e lëvrimin e studimit të shqipes, dhe po ashtu me njeriun që e kishte rrezatuar këtë status të bashkëkohësit, të cilët e shihnin si të tillë, e respektonin si të tillë, e angazhonin në shërbim të kulturës e dijes, duke qenë të bindur te vlerat e tij përveçse shkencore, edhe njerëzore. Dhe vetë këshillat e tij, edhe në rastet e intimitetit me bashkëbiseduesit ishin të mbushura me shqetësimin për zhvillimin dhe dijen. Ja çfarë i shkruan L. Nosi A Xhuvanit kur mëson për emërimin e tij në Kolegjin e Shën Miter Koronës³: “Nuk rëfeket gëzimi im qi bana, kur mora vesht nga letëra tate mi Bibën, të vumit tand si profesor i Shqipes në Kolegjet San Demetrit. Ç’kur se i shkrove tyt et nga Roma qi ike prej Athine, po prisjem pa durim si do bahesh puna jote. Po qoftë ndenj e zotit u ba n’ashtu si s’e shpresonte kurkush. Nashti pra e shpirtë i sigurumun nga nevojat e rojtjes i rethum nga ç’do rezik qi mund të na gjei neve e tyke qenë i lirë e i patutun të mash e prand vetin ç’do shkresë a librë të shtypur a të pa-shtypun të punojsh të vërdhojsh si të ndimë zemra e si ta pret mendja, kemi shpresë të madhe qi do të nderojsh Elbasanin me të ndjekun rrugën qi na kanë lanë Todër Haxhi Filipi e Kostandin Nelkoja.

Nuk do të ishte pun’ e vogël në qoftë se të vijë ndër mendt me nxjerë atje një ditarë Shqip me ligjërojet⁴ Elbasanit me të cilën punë do përpiqemi me sa na mund krahun ene me të holla, ashtu ene me shkresa. Atëherë do të gëzojë ne un qi të shpallin me të mëledhjet e mira e jo në Albanitë e cila lark shumë për neve.

Nuk lypset të tremesh as pak e të stepesh në kët punë; po o burra, t’a nderojmë Elbasanin e mos e lamë pas shokvet. Bane mend pra e m’u përgjigj për kët punë. Pyt se mund ti lujshtë aty muajt për këtë⁵. Neve këtu ngrefëm një shoqëri gjuhëtarësh e cila ka ndërmendit të shtypi me shkronjat e Sofies e në ligjërojet e Elbasanit në libra të zgjedhur, 40 a 50 faqesh.” [A. Q. Sh. i R. Sh. F. 3, D. 46, fl. 47-48].

Ndërsa në një letër tjetër dërguar nipit të tij, Sif Nosit, nga Brusa, më 25 janar 1911, ku ishte i internuar nga qeveria turke për shkak të qëndrimeve të tij kombëtare në faqet e gazetës Tomorri që botoi më 1910, Lef Nosi mes të tjerave i shkruan atij: “U gëzova shumë kur mora vesht nga letra jote si paske muftun me e bindun t’ët atë për me të lirimë qi të pasojsh mësimet e tua edhe nododhe aty. Kam shpresë se do t’i mundish gjithni pengimet qi të çfaqen nga yt atë e do t’i a arrishë qëllimit..... Un të këshilloj qi sido qi të ngajë puna ti të mos e lëshë qëllimin të pa krymun. Po të jetë qi të epesh pak pas Englishtes mund t’i bësh mësimet e nalta në London..... Sa për punë t’eme me gjithë qi shifet se do të lëshohem një ditë, po prap nuk mun të thom se kurë..... Si do qi të marri puna kam me të shkrumë.

3 Aleksandër Xhuvani filloi punë në Kolegjin e Shën Mitrit në 1906 deri më 1909.

4 Gjuhë, dialekt

5 Fundi i fjalisë i pakuftueshëm

Camodecca në e ka shtypë fjalorin më ço një copë. Edhe ndonji tjetër libër po të jetë shtypë andëi mi ço.

Të më mbëledhish ca këngë dashurie trimërie darsmash, përralla qi i dëftejnë gratë gocavet t'vogla, proverba, kafsha, prîma grashë, zakone darsmash, leje, vdekje. Po të gjitha t'i shkrushë besënisht në atë gjuhë qi i flet gjindëja aty e jo në gjuhë t'Elbasanit. Nuk them të ngutesh, po t'a marrish punën shtrumë nuk ka të bëji pse zgjat edhe gjashtë muaj. Të shkrushë plotësisht edhe atë qi më tregove:

Na jemi nga Elbasanë

Ku lâ më të mirët t'anë...

Normalja, shkolla e Korçës edhe gazetët Shqipe me gjithë shtypshkrôjat janë pa hapë se urdhëni qi udha qe fallso nga qi sundimtarët e vendit nuk lânë të hapen. Æsht e ditun qi janë dy lloj urdhnash: njëni zyrtarë edhe tjetri tinzarë. Gurakuqi pas lajmevet qi kanë nga Stambolli pritët të viji aty me gjithë Dervish benë.

Në Monastirë po përpiqen të hapin shtypshkrôjën me tjetër emën e të qisin një gazetë me emërin "Drita". Po nuk dimë a do t'a qillojnë këtë vepërim?" [A. Q. Sh i R. Sh. F. 32, D. 58, fl. 3-4].

Panorama që na shfaqet nga shqyrtimi i pjesshëm i këtij materiali është gjithsesi tejet përshtypjelënëse, sidomos: a) për nga numri i personazheve a personaliteteve në letërkëmbim: Në të janë të pranishme figurat më përfaqësuese të mendimit gjuhësor shqiptar të dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XX në rang kombëtar; dhe padyshim edhe ato të Elbasanit e shkollës Normale; b) për nga gjeografia e letërkëmbimit: Si njeri i veprimit, letërkëmbimi i tij do të adresohet jo vetëm nga Elbasani e pranë tij, por po ashtu edhe nga Vjena e Londra, nga Roma e Kalabria, nga Bursa a Athina ...; gjeografia e letërkëmbjesve do të jetë po ashtu nga skaje të ndryshme të Shqipërisë, por edhe jashtë saj; përftohet edhe në këtë letërkëmbim me këtë problematikë një lloj "Res publica literaria" e përditësuar me problematikën e shqipes dhe kulturës shqiptare, pjesëtarë të së cilës do të jenë qysh nga Konica e Gurakuqi, Peci e Xhuvani, Pekmezi e Prendushi, deri te Jokli e Petrota, E. Durhami e M. Hasllëku, Ç. Eriksoni a J. Godari..... etj. Ashtu si në "Res publica literaria", e krijuar si shtytje e ideve të Rilindjes Europiane e që parakuptone Republikën e të diturve, të letrarëve në shekullin e 18- e më tej, e sot atë të komunitetit shkencor, edhe në këtë trashëgimi të letërkëmbimit e bashkëpunimit të L. Nosit duket se krijohet kjo bashkësi dijetarësh që përbëjnë këtë republikë në atë hapësirë politike e ideologjike të turbullt e të pafavorshme.⁶

6 "Res publica literaria" e përfutur në shekullin e 18-të "synonte të nxirrte në pah të gjitha publikimet shkencore dhe të gjithë ata që ishin të vlefshëm në këmbimet shkencore: bibliotekarë, arkivistë, profesorë të universiteteve, historianë, teologë... etj.

Lef Nosi shfaqet si misionar në këtë *Res publika*. Ai do të komunikojë me austriakun N.Jokli e italianin G. Petrota, me anglezet E. Durham e M Hasllëk e amerikanin Ç. Erikson, me F. Konicën në Londër dhe Xhuvanin në Itali, me Gurakuqin e Cipon, kudo që të gjenden, me S. Pecin e K. Dakon në Amerikë a Gj Pekmezin a me Prendushin në Vjenë.

Statusi dinjitoz i L. Nosit në letërkëmbim dhe respekti, vlerësimi dhe adhurimi i letërkëmbyesve për të nuk vinte vetëm nga entuziazmi dhe vlerësimi që ata kishin për veprimin praktik dhe angazhimin e L. Nosit për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe arsimimit në gjuhën amtare, por edhe nga respekti për angazhimin e tij shkencor në fushë të gjuhës shqipe dhe njohurive që ai kishte për atë problematikë. Ja me ç'përgjegjësi e merr A. Xhuvani letërkëmbimin me të kur kërkon të shkëmbejë mendime për problemet gjuhësore, duke i shkruar nga Shën Miter Korone më 30 janar 1909: "Nuk me pelqyen as-pake ndryshimet qi i bane alfabetit "Bashkimi" ne bashke-ndénjet te Monastirit. Un kishjém édhé kam, méndimét é mija permbi kete çashtje; keto méndimé po te ndodhëshém ne bashke-ndénjet mun t'i thoshjém mé goje, po qi t'i shkruéjshem ne nji perkendim, si me shkruet ju mé Simonin, ishte é ástht édhé nji pune mundimtaré per mua, nga qi nuk é kam marre édhé mire fuqien sa-qi te rrij te méndohém é te baj nje t'atille pune méndaraké; nje ore pune méndaraké me bijé mue tani nji "stordimento"⁷, nje habie, nje ngaterrim mendje e gne dhime kréjt, pastaj xen é me dhemb édhé stomahi. Édhé kete létre qi po te shkruéj méxi po é mbaroj » [A. Q. Sh. i R. Sh. F. 32, D. 55, fl. 58-59].

Studimet e tij të pabotuara për gjuhën shqipe dhe historinë e saj dhe të popullit shqiptar janë tregues të penës së një dijetari e filologu të mirinformuar në lëmin e gjuhësisë, të familiarizuar jo vetëm me problematikën, por edhe me konceptet, metodologjitë dhe kategoritë gjuhësore që meritojnë shqyrtime shkencore dhe prej të cilave përftohen veçantitë e funksionimit dhe evoluimit të kësaj gjuhe. Ai njeh dhe komunikon, bashkëbisedon dhe me aftësi këshillon e sugjeron jo vetëm për problematikën e kësaj gjuhe, porë në aspektin sinkronik, ndaj të cilit ai ishte angazhuar qysh në rini të tij, por edhe për realitetin e zhvillimeve historike të shqipes. Ai njeh nga afër përkthimet dhe kontributet e autorëve të veriut në shekujt 16-17, arsyeton në lidhje me ndikimin e veprës së tyre në lehtësimin dhe komunikimin më të frytshëm në predikimet në kishë, shpjegon arsyet e ndërmarrjes së punës së Frang Bardhit (P. Françesko

Mjeti parësor i këmbimit në *literaria res publica* do të ishte epistolari, letërkëmbimi mes anëtarëve të kësaj "republike". Koncepti lindi prej idesë që në fushën e shkencës as dallimet e klasave, as ato të kombeve nuk ishin të rëndësishme. Në Europën e monarkive, dijetarët ishin një republikë më vete. Në fund të fundit, vetë emërtimi në etimologji vjen nga latinishtja: res – gjëja, ngjarja; dhe publica – që i takon popullit.

7 Ita. trullosje

Blankut, siç shënon ai), i cili pas “Don Gjon Buzukut, Pjetër Budit dhe P. Bogdanit, ndërmori nismën për realizimin e një fjalori latin-shqyp me rreth 5000 fjalë, ndjekë prej disa regullave gramatikore, prej proverbase e prej një dialogu”. [F.32, D;213, V. Pa vit, fl.1 j..g.]

L. Nosi qëndron i kthjellët përballë veçantive që shfaqen në rrugët e evoluimit të shqipes, duke shpjeguar arsyet e ndikimit të gjuhëve të tjera mbi të dhe huazimet nga latinishtja (kryesisht në literaturën e priftërinjve katolikë), greqishtja (në përkthimet dhe predikimet ortodokse) dhe turqishtja, arabishtja dhe persishtja në krijimtarinë e bejtexhinjve (L.Nosi sjell për ilustrim veprën e Nezim Beut) [po aty, fl. 2].

L. Nosi i referohet Hahnit (albanologu i përmendun, Hahn – thotë ai) dhe shënimeve të tij për gjuhën ilire i cili, duke njohur përpjekjet e bëra në shekullin XIX për shkrimin e poezive në shqip (bejtexhinjtë) nuk ngurron të miratojë këto përpjekje (“tingëllimet e Nezimit”) “fillojnë t’i japin pak shpresë, pak dritë mbi t’ardhmen e gjuhës shqipe” [po aty, fl. 2].

Gjithsesi, L. Nosi mundohet të jetë sa më i qartë dhe objektiv në lidhje me pikëpamjet për gjuhën shqipe dhe vlerat e përfutuara në të, duke iu referuar edhe ideve jo shumë entuziaste, të cilat theksonin për shqipen natyrën e përzier të saj prej huazimit në të të shumë “elementeve të huaj” [po aty, fl.2].

Me respekt dhe entuziazëm L. Nosi shkruan për gjuhën e përpunuar në krijimet tek arbëreshët e Italisë, ku “lulzuen vargjet e vërtetë të punueme e qi nderojnë në pikpamje estethike prodhimin t’one e t’asaj kohe. Asht për t’u admirue në kët mest, stili, bukurija e perfeksioni i Jul Varibobës, qi në një poem polimetrik këndoi “La vita di Santa Maria Vergine” [po aty, fl.2]. Ai njeh dhe vlerëson punën e personaliteteve arbëreshe të shekullit XIX për lëvrimin e shqipes, për mësimin e saj, mbledhjen e këngëve popullore, rapsodive, etj., duke shprehur respekt njëherazi për, sipas tij, “të mirnjohtunit Michele Marchiano i cili mbajti kathedren e gjuhës shqype të themelueme n’Institutin Linduer të Napolit e qi përpiloi veprat: ‘Canti di Bardi Nella terra straniera’, ‘Mili e Haidha’ [po aty, fl.2]. Po ashtu ai thekson: “Prej kangve epike kombtare kje ruejt në Shqypetarët e Siçiljes gjithnji legjendar ‘Skanderbegu’. Rreth tij këndoishin rapsodinat ma te bukura, të cilat ma vonë (1866), kjenë mledhë me kujdes e shtypë në një libër poezinash prej dorës së çmueshme të Girolamo de Rades” [po aty, fl.2].

Me dhimbje ai përmend pengesat që iu ngritën shqipes nga pushtimet. Ai thekson: “Dyndja e popujve aziatikë në vendet shqiptare, jo vetëm qi na damtoi politikisht, por as qe nuk permetoi qi gjuha e jonë të lretë dy hapa përpara” [po aty, fl.2].

Lef Nosi vlerëson Kongresin e Manastirit, duke theksuar veçanërisht dy synime të tij: 1. “me njajtësue shkronjat për Gegë e Toskë mbrenda e jashta

Shqipnisë në të mirë të bashkimit të kombit; me drejtshkrue (? nuk dallohet mirë) shqipen me një mënyrë sa ma tingullore që t'ishte e mundshme në të mirë të zgjimit të popullit... t'ue lanë me një anë Shqiptarët e Italisë, asht një e vërtetë historike me thanë se të parit qëllim pa shkue shumë kohë u mbërrijtë për faqe të bardhë; 2. ...për hir t'alfabetit të Monastirit, parimi i drejtshkrimit tingulluer që çdo tingull të shenjohet gjithmonë..... u ra bukur mirë në të" [po aty, fl.3, e daktilografueme].

Me logjikë dhe qartësi L. Nosi futet në problematikën e historisë së popullit shqiptar, të hershmërisë së tij në trojet ku jeton sot, të prejardhjes dhe lidhjes së tij me popujt fqinj. Në parashtrimet e tij ai u referohet paprerë albanologëve dhe studiuesve autoritarë të kohës. Paraprakisht ai shqyrton faktin se përse "historia nuk na thotë kurrëgjatë përmirë rrjedhjen e Shqiptarëve sot që banojnë vendet e Ilirisë e t'Epirit të dikurshëm". Dhe ai thekson: "E shkaku ma i pari i njoftimeve të mangëta përmirë histori shqyptare asht mungesa e burimevet". [po aty, fl.4].

L. Nosi ishte i mirinformuar, njihte dhe u referohej drejtpërdrejt tezave më të rëndësishme që lidheshin me prejardhjen ilire të popullit shqiptar dhe shtyhej edhe më tej për të parë edhe lidhjen ilire-pellazge. Ai u drejtohet më së pari studiuesve që pranojnë vjetërsinë e gjuhës shqipe dhe karakterin indoeuropian të saj. Ai pohon se "...fonetika e saj dhe etimologjia, asht në lidhje me gjuhët ma të vjetra, me ato që i përkasin grupit Indo-Europian". [po aty, fl.1]. E më tej vazhdon: "Tue zanë fill prej saj, albanologët e shquem gjetën rrajë të ngjashme e të njajta me Rumanishten, Thrakishten, Greqishten, Sanskritishten etj...[po aty, fl.1]. Libra tavoline të tij, të cilëve ai u referohet me citime të drejtpërdrejta ishin "Albanesische studien" e Georg von Hahnit, "....." e Bruek-t, "A History of the Pelasgian Theory" e Myres-it, "Pelasgica" e Pareti-t, "Historija e Grekis e e Romës" e Herlzbergut, veprat e Herodotit, Strabonit, Dionisit të Halikarnasit e deri te Iliada e Homerit, autorë të tjerë të kohëve të reja si P. Cesare de Cara S. I. (arkeolog i përmendun e historian i kohëve të vjetra, siç thekson ai), F. Bopp-i, G. Majeri L. Benlëvi, A. Dozoni, Jakob Tomopuli, revistat shkencore të kohës "Civiltà Cattolica", Revue de Philologie etj.

Për çështjen "a kemi dalë prej ilirëve?", ai i referohet Majerit, Benlëvit, Straticoit, duke ballafaquar hipotezat e tyre. (Përqas tezat e Majerit të shprehura në "Gustav Meyer, della lingua e lettera, alb.nuova ant., vol. 50, 1885).

Dëshminë më të sigurt për prejardhjen e shqiptarëve L. Nosi e sheh në shqyrtimin e gjuhës shqipe. Ai thekson: "Por studjimi ditunuer i gjuhës shqype mundet me na dftue ma mirë se cillit grup etnik na i përkasim" [po aty, fl.8]. Për interpretime më të gjera në lidhje me shqipen ai u drejtohet A. Dozonit me "Manuel de la langue chcipe", paris 1879, Prefation të Hahnit, Meyr-it, J. Tomopuli-t etj.

Pasi parashtron tezat e autorëve L. Nosi përpiqet të përgjithësojë: “Por në mjedis të gjith ktyne mendimeve të ndryshme, me të cillat gjuha e jonë tash bashkohet me grekishte, tash me latinishte, tash me sllavishte e tash me rumanishte, prap nuk mundet kush me i a mohue pamvarsin, për shkajk të karaktereve të veçanta fonetike, morfologjike e leksikore”. [po aty, fl. 9]. Dhe mbi këtë bazë vijon analizat e tij me aftësinë e filologut dhe dijetarit, që shfaqet në marrjen në analizë të dukurive gjuhësore, në aparatin konceptual që e çon në kahjet e asaj analize dhe në terminologjinë gjuhësore të përdorur saktë brenda fushave të ndryshme të gjuhësisë. Ai analizon mendime të pambështetura sa duhet të Meyer-it, i cili, duke parë ndikimin e rumanishtes a latinishtes në shqipe pohon “se për pakë gjë gjuha e jonë nuk u ba romanzen”, ose polemizon/rrangatet me tezën e Benlëvit sipas së cilës “na kemi dalë prej viseve t’afërme t’Armenve e të Puano-Kokve (???) e gjuha e jonë asht gjuhë kaukaze” [po aty, fl.10]. Për këtë tezë L. Nosi vëren: “Për me diftue sa e pavend asht fjala e tij e fjala e atyre qi mendojn si ai mjafton me thanë se gjuha shqype asht fleksive. Ase ma mirë: fjala e sajë shkon tuj ndrrue temën e rrajën simas skajimeve të lakimit e të përkthimit” [po aty, fl. 10]. Më tej vazhdon: “Ndërsa gjuha turqishte, mongole e Tungusce (??) me të cillat Benlou përzien gjuhën t’onë, janë të gjitha gjuhë aglutinante. Domethanë, fjala nder to përbahet prej elementave t’ bashkuem, të pashkrim nder vedi e të dashem” [po aty, fl.10].

Mëse një herë ai thekson që përcaktimi i natyrës së shqipes duhet bërë duke njohur mirë historinë e saj dhe historikun e ndikimeve të gjuhëve të ndryshme me të cilat ajo qe në kontakt ose nën trysni. Ai thekson: “Me dashtë me njoftë prandaj shka ka të veten gjuha shqype, lypet ma parë me da elementat e huej prej gjuhës s’one e me studjue influksin qi kan pasë gjuhët tjera në gjuhën t’one, nder kohë të ndryshme...Por mungesa e dokumentave gjuhsor të cilët munden me na diftue fazet e ndryshme të zhvillimit të sajë fonetik, nuk na len me ba një studjim glotologjik permi gjuhen shqype” [po aty, fl.10].

L. Nosi pozicionohet mirë në rolin e historianit të gjuhës shqipe dhe me argumente gjuhësore dhe metodologji gjuhësore-krahasuese synon të dalë në përfundime. Spikat në qëndrimet e tij: marrja parasysh në shqyrtim e parimit të historizmit dhe përqasja e dukurive nga ky kontekst; vështrimi i dukurive në evoluim, me veçanti, gjithsesi, në nënsistemet e ndryshme të gjuhës, sidomos në atë fonetik, gramatikor e leksikor; aftësia për të përgjithësuar dhe vënë në vendin e duhur statusin a natyrën e gjuhës, në sajë të veçantive që shfaqin grupe a familje të ndryshme gjuhësore (sipas tij, flektive, aglutinative, satem, centum).

Dhe në çdo rast ai mbetet brenda. logjikës relativiste në përfundime, gjithnjë duke përqasur tezat dhe hipotezat. Ai përqas tezat e Kamardës me ato të Meyer-it, duke analizuar “sistemin e lakimit në shqipe, greqishte

e latinishte për nga sufiksats nder emna si nder verba, apo peremna ku hetohen elementa rrajore të barabarshëm” [po aty, fl.11]. Duke vërejtur pikat e dobëta të tezave të Kamardës dhe Meyer-it, L. Nosi parashttron domosdoshmërinë e vështimit të përafrive të shqipes me rumanishten, përafri të cilat ai i sheh në shumë aspekte: 1. Në mënyrën e përfutimit të emrave foljorë në të dyja gjuhët. Ai shkruan: “Trajtojm emna verborë, si ata, si na, prej participit të perfektit, qi ma të shumtën e herës në gjuhë t’onë nuk asht tjetër veç trajta e infinitivit e në gjuhë rrumanishte i përgjegjë supinit për të përfutur shquarsinë”. 2. Në përdorimin e mbaresave. Ai thekson: “Caktojm emnat nepërmjet artikullit qi u njesim në marim”; 3.në përfutimin e një sistemi rasor me disa rasa të njëjta; ai thekson: “Kemi dy trajtë të vetme për genitiv e dativ”; 4. në praninë e ndërrimeve të njëjta tingullore si metaforia etj.; ai thekson: “si nder fjalë të vjetra, si nder fjalë të marruna prej gjuhve t’hueja ndrrojm zanoren e trupit “a”, në njajës, me “ë” në shumës” [po aty, fl. 12].

Më tej, për të motivuar përkatësinë e shqipes si degë më vete në familjen e gjuhëve indoeuropiane L. Nosi u referohet tezave të G. Meyer-it, Max Müller-it, F. Bopp-it, duke sjellë informacione të hollësishme për qëndrimin e tyre (shih po aty, fl. 13). Po ashtu, në pozicionin e historianit të gjuhës ai kërkon të qartësojë edhe vendin e shqipes sipas këndvështrimit e klasifikimit të tyre në Centum e Satem, në varësi të ndërrimit të qiellzoreve. Pasi sqaron se ç’janë “centum lingue” e “satem lingue”, me një terminologji të saktë e të mirëfilltë gjuhësore, L. Nosi pohon se “gjuha e jonë shkon me grupin satam lingue” [po aty, fl.14].

Pjesë e shqyrtimeve të tij për albanologjinë është edhe një syth i veçantë (jo i plotë në materialin e gjetur prej nesh) i titulluar “Leteratyra shqype”, ku ai nis të shqyrtojë faktin se pse në hapësirën kulturore shqiptare nuk ka pasur zhvillimin e duhur letërsia (sërish vijnë motivimet me arsyet historike të zhvillimit të popullit shqiptar) dhe arrihet në nota entuziaste për aktualitetin, ku shkrimtarët janë gjithnjë e më të pranishëm.

Por L. Nosi është i kujdesshëm në analizë dhe objektiv në shqyrtim. Ai di të shohë mangësitë, por edhe vlerat. Ai pohon: “Por në kjoftë se na nuk kemi pasë deri më sot një leteratyrë komtare riflekse, kemi leteratyrën t’onë popullore, e cilla mundet me ndejë krahas me leteratyrë ma të bukura t’Europës” [po aty, fl.15].

Ja çelësi i shpjegimit të pasionit të tij për mbledhjen, shqyrtimin dhe botimin e materialit dialektor e folklorik.

Dhe komunikimi a letërkëmbimi me një personalitet të tillë të formuar e të informuar në lëmë të shqipes, pa dyshim që do të ishte një mbështetje për personalitete në rritje e formim si A. Xhuvani, K. Cipo, S. Shuteriqi etj., por edhe një mundësi për këmbim idesh, opinionesh tezash e hipotezash mes tij dhe personalitetve të tilla si L. Gurakuqi, F. Konica, G. Petrota, Ç.

Eriksoni, E. Durhami, Margret Hasllëku, etj. Lef Nosi tërhiqte vëmendjen, përkujdesjen dhe interesimin e tyre me pushtetin e dijes së grumbulluar, me enciklopedizmin e tij dhe pasionin e pashtershëm për njohje.

*Nam et ipsa scientia potesta est*⁸ – thoshte latini. L. Nosi ishte i pajisur me këtë forcë mrekullisht.

Abstract

There are prominent Albanian figures who have somehow neglected the publication of their works, being committed to *action*, and in this case, the *correspondence* and *scholarly notes* assume special importance. That is the case with Lef Nosi's contribution to Albanian culture. Reading his correspondence and parts of his *scholarly notes* (on Albanian and linguistics) serves to underscore particular aspects of his contribution, which were long forgotten after his being sentenced to death and executed in 1945. The present study aims at highlighting the underlying message of his scholarly activity in the field of Albanian studies to which he devoted his whole life.

8 Vetëm dituria është forcë !